



## KUMTESË

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës (UPRK) në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2019 në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kishte në rend dite disa pika në të cilat ndër të tjera u diskutua edhe rreth:

- Procesit të (ri)akreditimit institucional dhe të programeve studimore;
- Përgatitjeve për regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2019/2020;
- Thellimit të bashkëpunimit të UPRK-së ndërmjet vete dhe me universitetet simotra nga Shqipëria, Maqedonia dhe ato ndërkombëtare;
- Krijimit të grupeve punuese dhe komisioneve për përgatitjen e dokumenteve që do të mundësonin avancimin e statutit të Universiteteve Publike dhe pavarësimin e tyre financiar;
- Përgatitjeve për organizimin e një konference ku do të debatohej për gjendjen aktuale dhe perspektivën e Arsimit të Lartë në Kosovë.

Në takim u përcaktua dinamika e aktiviteteve dhe takimeve në vazhdim në mënyrë që të realizohen detyrat e parashtruara nga Konferenca e Rektorëve të UPRK-ëve.

Pejë, 08.05.2019

Zëvendës kryesues i Konferencës së Rektorëve

Prof.Dr. Fadil Millaku

Rektor, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë